



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

U D H Ë Z I M Nr. 2, Datë 8. 03. 2007

**PËR
TË GARANTUAR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË PROCESIN
PENAL**

Me synim, për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e procesit penal;

Në mbështetje, të nenit 24 pika 4 e vijues të K. Pr. Penale dhe të nenit 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Prokurorët dhe oficerët/agjentët e policisë gjyqësore të të gjithë strukturave dhe niveleve, të garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit në procesin penal dhe për këtë të mbikëqyren nga drejtuesit e strukturave përkatëse të të gjithë niveleve në prokurori dhe në policinë gjyqësore.

2. Prokurorët e shkallës së parë, duhet të shqyrtojnë dhe të kontrollojnë me hollësi ligjshmërinë e veprimeve hetimore të kryera nga policia gjyqësore, duke garantuar respektimin e drejtave të njeriut nga policia.

3. Oficerët dhe/ose agjentët e policisë gjyqësore që kanë kryer një arrestim në flagrancë ose ndalim ose që kanë shoqëruar një person ndaj të cilit zhvillohen hetime ose që kanë marrë në dorëzim të arrestuarin, ndaluarin apo shoqëruarin, duhet të njoftojnë menjëherë prokurorin¹ e gatshëm dhe/ose drejtuesin e Prokurorisë të shkallës së parë që ka në kompetencë lëndore ndjekjen penale ose prokurorin e gatshëm apo drejtuesin e Prokurorisë të shkallës së parë të vendit ku është kryer arrestimi, ndalimi ose shoqërimi.

¹ Shih, nenet 255/1 e 295/3 të K. Pr. Penale

4. Në këto raste, prokurori i gatshëm ose prokurori i caktuar nga drejtuesi i prokurorisë, menjëherë duhet të kontrollojë ligjshmërinë e veprimeve hetimore të kryera dhe respektimin e të drejtave të njeriut nga policia gjyqësore.

5. Prokurori duhet të marrë në pyetje të arrestuarin ose të ndaluarin në praninë e mbrojtësit, duke i njoftuar atyre faktin për të cilin procedohen dhe arsyet e marrjes në pyetje². Nuk duhet të ndodhë që të arrestuarit ose të ndaluarit të merren në pyetje nga oficeri i policisë gjyqësore, pa patur urdhër delegimi të posaçëm nga prokurori.

6. Gjatë pyetjes së të arrestuarit ose ndaluarit apo personit të shoqëruar³ prokurori duhet të verë re nëse ata kanë shenja keqtrajtimi. Në rastet kur konstatohen shenja keqtrajtimi apo kur të arrestuarit, ndaluarit apo të shoqëruarit ankohen për keqtrajtim nga ana e policisë gjatë arrestimit apo qëndrimit në polici, prokurorët duhet të veprojnë menjëherë për të verifikuar keqtrajtimin⁴, duke vlerësuar dhe vendosur sipas rastit regjistrimin kryesisht të njoftimit të veprës penale, dhe të njoftojnë autoritetin përkatës të policisë për keqtrajtimin.

7. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të garantojnë të drejtën e mbrojtjes të arrestuarit, ndaluarit, të pandehurit ose personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.

7.1 Kur i arrestuari, i ndaluari, i pandehuri apo personi nën hetim kanë zgjedhur mbrojtës ose kanë kërkuar ti caktohet një mbrojtës kryesisht, gjithmonë pyetja e tyre duhet të bëhet në praninë e mbrojtësit⁵. Përgjithësisht nga ky rregull mund të bëhet vetëm kur marrja e të dhënave nga personi ndaj të cilëve zhvillohen hetime, kryhet në vendin e ngjarjes ose për veprat penale të dukshme⁶, para shoqërimit, arrestimit apo ndalimit të personit.

7.2 Në rastet kur kërkohet caktimi i një mbrojtësi kryesisht, prokurori para caktimit të tij, t'i vejë në dispozicion të arrestuarit, ndaluarit, pandehurit apo personit nën hetim listën e avokatëve që marrin pjesë në mbrojtjen e caktuar kryesisht, për ti krijuar mundësi atyre për të zgjedhë një ndër avokatët e listuar⁷.

7.3 Kur mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk siguron mbrojtje juridike efektive, mbi ankimin apo kërkesën e të arrestuarit, ndaluarit, pandehurit apo personit nën hetim ose kryesisht, prokurori, pasi vlerëson

² Shih, po aty, neni 256.

³ Shih, po aty, neni 295/3.

⁴ Shih, udhëzimet/porositë e dërguara me qarkoren nr. 228/1, datë 03. 03. 2006 "Mbi Raportin e KE për Parandalimin e Torturës (CPT)

⁵ Shih, po aty, nenet 48/1 e 49/7, 35, 296/1

⁶ Shih, po aty,, neni 296/2.

⁷ Shih, po aty,, nenet 49/1

vlerëson se ekzistojnë shkaqe të përligjura⁸, vendosë caktimin e një mbrojtësi tjetër zëvendësues, duke respektuar procedurën e sipër përmendur në pikën 7.2.

7.4 Avokati mbrojtës nuk është e nevojshme të kërkojë autorizim nga prokurori për të vizituar ose kontaktuar me klientin e tij të arrestuar apo ndaluar, por është e mjaftueshme që ai të ketë prokurorë nga personi i arrestuar apo ndaluar ose familjarët e tij ose vendimin e prokurorit për caktimin kryesisht të tij, si dhe licencën e lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

8. Prokurorët e shkallës së parë, duhet të bëjnë kujdes në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për caktimin e masave të sigurimit⁹, për të zgjedhur dhe kërkuar në gjykatë masa të përshtatshme të sigurimit personal, duke *shmangur çdo masë sigurimi në kundërshtim me ligjin*, si dhe duke *reduktuar kohëzgjatjen e masës së arrestit në rastet kur kjo masë është urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetimin e provës*.

9. Prokurorët e shkallës së parë, çdo dy muaj nga zbatimi i një vendimi arresti, duhet të informojnë me shkrim gjykatën që ka dhënë vendimin¹⁰, lidhur me ecurinë dhe gjendjen e procedimit, për pyetjen e të pandehurit të arrestuar dhe të personave të tjerë të lidhur me të, për të dhënat dhe rrethanat e reja të administruara, informacion i cili shoqërohet me kopje të akteve përkatëse të nxjerra nga fashikulli i hetimit.

10. Prokurorët duhet të bëjnë kujdes në vlerësim, mbështetur në ligj dhe në prova, në çdo rast të ngritjes së akuzës apo ndryshimin e saj ndaj personit që i atribuohet vepra penale, duke shmangur çdo rast të ngritjes së akuzës apo ndryshimin e saj, të pambështetur në ligj dhe në prova, me synim shmangien më pas të pushimit të çështjes ose akuzës apo pafajësisë me ose pa të arrestuar.

11. Prokurorët duhet të garantojnë barazinë përpara ligjit dhe të bëhen të ndërgjegjshëm për të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me çështjen, duke vlerësuar si rrethanat që rëndojnë ashtu edhe ato që shfajësojnë të dyshuarin, personin nën hetim apo të pandehurin.

12. Prokurorët, në fazën e hetimeve paraprake, duhet të vlerësojnë në kohë vlefshmërinë e akteve procedurale të policisë gjyqësore dhe nuk duhet të paraqesin prova kundër të dyshuarit, personit nën hetim, apo të pandehurit, në rastet kur ata dinë ose besojnë bazuar në shkaqe të arsyeshme, që provat janë siguruar nëpërmjet përdorimit të metodave të cilat janë në kundërshtim me ligjin. Në fazën e gjykimit, në raste të dyshimta të pretenduara, prokurorët duhet t'i kërkojnë gjykatës të vendosë mbi vlefshmërinë e

⁸ Shih, po aty,, nenet 49/5,6 e 51

⁹ Shih, po aty, nenet 228, 229

¹⁰ Shih, po aty, neni 246/6

provave të tilla.

13. Në të gjitha rastet kur evidentohen shkelje të të drejtave dhe lirive të individit në procesin penal ose kur jepet pafajësi nga gjykata, pushohet çështja ose akuza me ose pa të arrestuar, ndryshohet kualifikimi i veprës në gjykatë apo shpallet pavlefshmëria e akteve të policisë gjyqësore, drejtuesit e prokurorive përkatëse, brenda 3 ditëve, të organizojnë analiza të përbashkëta me pjesëmarrjen e prokurorit/ve të çështjes dhe/ose oficerit/ve të policisë gjyqësore, me synim për të evidentuar shkeljet dhe personat përgjegjës.

13.1. Në këto raste, brenda 7 ditëve, drejtuesi i prokurorisë duhet të informojë me shkrim Prokurorin i Përgjithshëm, për shkeljet ligjore të vërtetuara dhe përgjegjësinë e personave përgjegjës (prokuror ose oficer të policisë gjyqësore), duke referuar masat e marra për zgjidhjen e çështjes dhe propozimet për masa disiplinore ndaj personave përgjegjës.

14. Për shkelje të të drejtave dhe lirive të individit në procesin penal që nuk përbëjnë vepër penale dhe/ose për shkelje të tjera të ligjes procedurale të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët të fillojnë procedimin disiplinorë ndaj tyre, në mbështetje të neneve 14 e 15 të ligjit nr. 8677, datë 2. 11. 2000 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore".

15. Me këtë udhëzim të njihen oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjithë niveleve.

16. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve, si dhe të strukturave të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Kon&KomKL
5. 03. 07

THEODHORI SOLLAKU

